

L I G J

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË PARANDALIMIT TË LARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 1

Në Ligjin e Parandalimit të Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 120/18), në nenin 14 paragrafi (1), pika a) ndryshohet dhe bëhet:

"a) identifikimi i klientit dhe vërtetimi i identitetit të tij duke shfrytëzuar dokumentet, të dhënat dhe informatat nga burime të sigurta dhe të pavarura, duke përfshirë, nëse është e mundur, me përdorimin e mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në pajtim me ligjin;"

Pika b) ndryshohet dhe bëhet:

"b) identifikimi i autorizuesit dhe vërtetimi i identitetit të tij duke shfrytëzuar dokumentet, të dhënat dhe informatat nga burime të sigurta dhe të pavarura, duke përfshirë, nëse është e mundur, me përdorimin e mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në pajtim me ligjin."

Neni 2

Në nenin 15 paragrafi (3) fshihet.

Paragrafët (4) dhe (5) bëhen paragrafë (3) dhe (4).

Neni 3

Në nenin 16 paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

"Kur klienti është person fizik identifikohet dhe vërtetohet identiteti i tij duke parashtruar dokument origjinal dhe të vlefshëm për identifikim, të lëshuar nga organi kompetent, ose kopje të verifikuar në noter, ose nëse është e mundur me përdorimin e mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në kuadër të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në pajtim me ligjin."

Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

"(2) Nga dokumenti sipas paragrafit (1) të këtij neni, por, nëse është e mundur, edhe nga të dhënat për identifikim të personave që përdorin mjete për identifikim elektronik, konstatohet emri, mbiemri, data dhe vendi i lindjes, vendi dhe adresa e vendbanimit ose vendqëndrimit, numri unik i amzës ose numri për identifikim dhe numri I dokumentit të identifikimit ose numri serik i mjetit për identifikim elektronik, organi që e ka lëshuar dokumentin dhe vlefshmëria e tij, përkatësisht emri i lëshuesit të identifikimit elektronik dhe periudha e vlefshmërisë së mjeteve për identifikim elektronik."

Paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

"(5) Subjektet detyrimisht mbajnë kopje në letër të dokumenteve sipas paragrafëve (1) dhe (3) të këtij neni, si dhe të regjistrimeve elektronike sipas paragrafëve (1) dhe

(3) të këtij neni për identifikim të personave të siguruar nëpërmjet mjeteve të identifikimit elektronik të lëshuar në suaza regjistrave të skemës elektronike për identifikimi, gjatë së cilës zbatohen masa teknike organizative në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale."

Neni 4

Pas nenit 23 shtohen dy tituj të rinj 23-a dhe 23-b, dhe bëhen:

"Pronari i vërtetë i personit juridik në pronësi shtetërore

Neni 23-a

Pronar i personit juridik në pronësi shtetërore është personi juridik në pronësi shtetërore i cili drejtor ose udhëheq me organin drejtues të personit juridik në pronësi shtetërore.

Pronar i vërtetë është personi juridik i cili është në procedurë falimentimi ose likuidimi

Neni 23-b

Pronar i vërtetë është personi juridik i cili është në procedurë falimentimi ose likuidimi, është drejtori i falimentimit, përkatësisht likuiduesi deri në përfundimin e procedurës së falimentimit, përkatësisht likuidimit.”

Neni 5

Në nenin 25 në paragrafin (1) në pikën 2., lidhëza “dhe” zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 3., pika zëvendësohet me pikëpresje dhe shtohen tri pika të reja dhe bëhet:

“4.Shfrytëzues buxhetorë;

5.persona juridikë në pronësi shtetërore dhe

6.personi juridik në procedurë falimentimi ose likuidimi.”

Në paragrafin (2) pika a) nën-pika 2. fjala “shteti” zëvendësohet me fjalën “adresa”.

Në paragrafin (3) pas fjalëve: “pika 3” vihet presje dhe shtohen fjalët „4, 5 dhe 6”

Neni 6

Në nenin 26 në paragrafin (3) pas fjalëve: “tregtarë individë” vihet presje dhe shtohen fjalët: “persona që kryejnë autorizime publike, shfrytëzues buxhetorë, persona juridikë në pronësi shtetërore dhe persona juridikë në procedurë falimentimi dhe likuidimi”.

Në paragrafin (4) fjalët: “paragrafët (1) dhe (2)” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi (3)”.

Neni 7

Në nenin 28 paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet: “Në regjistrin regjistrohen të dhënat vijuese:

a) të dhënat për subjektin juridik: emërtimi, selia, NVAS dhe numri tatimor, data e themelimit dhe fshirja e subjektit afarist, të cilat me detyrë zyrtare dhe automatikisht merren dhe evidentohen nga regjistri i vetëm tregtar dhe regjistri i personave tjera juridike,

b) të dhëna për pronarin e vërtetë: emri dhe mbiemri (emri personal), numri unik i amzës ose numër tjetër të identifikimit, adresa e vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin, data e lindjes dhe shtetësia, të cilat me detyrë zyrtare dhe me shfrytëzimin e mjeteve elektronike merren nga Regjistri qendror i popullsisë, me futjen e numrit unik të amzës të qytetarit, për qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët jetojnë në shtetin ose në vend të huaj, si dhe shtetas të huaj me qëndrim të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut më gjatë se një vit ose futen nga parashtruesi për shtetas të huaj;

v) të dhënat për pronësinë e pronarit të vërtetë. Paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

“Administratori i regjistrin e mban dhe administron regjistrin në mënyrë që:

- krahas statusit të fundit të të dhënave për pronarët e vërtetë, gjithashtu ruhen të gjitha shënimet, ndryshimet e të dhënave dhe fshirja sipas kohës dhe llojit të ngjarjes dhe

- të dhënat në regjistrin janë të disponueshme dhjetë vjet pas fshirjes së subjektit juridik nga regjistri kompetent.”

Paragrafi (3) ndryshohet dhe bëhet:

“Shënimi i të dhënave bëhet në formë elektronike, nëpërmjet ueb portalit të administratorit të regjistrin, pa kompensim në afatet e parapara ligjore, duke zbatuar masa teknike dhe

organizative në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.”

Neni 8

Në nenin 29 në paragrafin (2) pas fjalës “arritshme,” shtohen fjalët: “në formë të informatës”.

Pas paragrafit (2) shtohen dy paragrafë të rinj (3) dhe (4), dhe bëhet:

“(3) Informata sipas paragrafit (2) të këtij neni lëshohet në pajtim me të dhënat e regjistruara në Regjistrin Qendror të Popullsisë në ditën e lëshimit të saj.

(4) Informata për pronar të vërtetë të tregtarit individ, ushtruesit e mëvetësishëm të veprimtarisë dhe personat që kryejnë autorizime publike, si dhe shfrytëzuesit buxhetorë, personat juridikë në pronësi shtetërore dhe personat juridikë në procedurë falimentimi dhe likuidimi lëshohet në pajtim me të dhënat e fundit të regjistruara në regjistrin unik tregtar dhe regjistrin e personave tjerë juridikë dhe regjistrin e shfrytëzuesve buxhetorë në kompetencë të Ministrisë së Financave.”

Neni 9

Në nenin 32 paragrafi (6) fshihet.

Neni 10

Në nenin 35 në fjalinë hyrëse, pas fjalës “identifikim”, shtohen fjalët: “ose nëse identiteti i tyre nuk mund të përcaktohet me përdorim të mjeteve për identifikim elektronik të lëshuara në korniza të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në pajtim me ligj.”

Neni 11

Në nenin 39 në paragrafin (3) pika në fund të fjalisë fshihet dhe shtohen fjalët: “në pajtim me nenin 56 të këtij ligji.”.

Paragrafi (4) ndryshohet dhe bëhet:

“Në rastet sipas paragrafit (1) të këtij neni, subjekti është i detyruar që të përgatisë analizë me shkrim dhe ta konstatojë nevojën për dorëzim të raportit në drejtori në pajtim me nenin 54 të këtij ligji. Subjekti është i detyruar që ta ruajë analizën dhe ta bëjë të disponueshme me kërkesë të organeve mbikëqyrëse sipas nenit 146 të këtij ligji.”

Neni 12

Në nenin 51, paragrafi (1) ndryshon dhe bëhet:

“Subjektet janë të detyruara kopjet nga dokumentet, përkatësisht shkresat elektronike nga të dhënat të siguruar me përdorim të mjeteve për identifikimin elektronik të lëshuara në korniza të skemës së regjistruar për identifikim elektronik në pajtim me ligj, me të cilat përcaktohen dhe verifikohen, përkatësisht e identifikojnë dhe autentifikojnë identitetin e klientit, të autorizuarin dhe pronarin e vërtetë, për procedurat e zbatuara për analizë të klientit ose pronarin e vërtetë dhe për transaksionet e realizuara ose transaksionet në tentim, dosjen e klientit dhe korrespondencën afariste, t’i ruajnë dhjetë vjet në formë elektronike ose të shkruar sipas transaksionit të realizuar, llogaritur nga transaksioni i fundit.

Neni 13

Në nenin 53 paragrafi (5) ndryshohet dhe bëhet:

“Shoqëritë e sigurimit që kryejnë punë të sigurimit të jetës të dhënat e mbledhura për policat e lidhura për sigurim të jetës i dorëzojnë në drejtori në fund të ditës në formë elektronike në rastet vijuese:

- për policat e lidhura për sigurim të jetës me arkëtim të premisë për policë për sigurim të jetës në shumë të barabartë ose më të madhe se 15.000 euro dhe pagesë në bazë të grumbullimit, huas ose përjetimit njëjtë ose më të madh se 15.000 euro në kundërvlerë denari sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në ditën kur është lidhur polica e sigurimit, përkatësisht në ditën kur bëhet pagesa, përveç marrëveshjeve të sigurimit të jetës në rast të vdekjes- sigurim të rrezikut dhe

- për policat e lidhura për sigurim të jetës nga ana e bartësit të funksionit publik, pa marrë parasysh vlerën e shumës së siguruar.”

Neni 14

Në nenin 57 në paragrafin (6) në pikën b) fjala “lartë” zëvendësohet me fjalët: “së paku të mesëm”.

Paragrafi (7) ndryshohet dhe bëhet:

“Te subjektet sipas paragrafit (2) të këtij neni, personi i autorizuar, zëvendësi i tij, si dhe të gjitha personat e punësuar në njësinë sipas paragrafit (3) të këtij neni, u nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në pajtim me rregullat e sigurisë së informacioneve të klasifikuara dhe nevojitet që të kenë certifikatë të sigurisë.”.

Neni 15

Në 58 pas fjalës “vjetor” shtohen fjalët: “gjatë vitit rrjedhës për vitin paraprak”.

Neni 16

Në nenin 63 fjala “dorëzojnë” zëvendësohen me fjalët: “sigurojnë, dorëzojnë dhe japin”.

Neni 17

Në nenin 74 në paragrafin (2) pika 4) ndryshohet dhe bëhet:

“të ketë njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të shfrytëzuara (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht).”

Neni 18

Në nenin 83 fjala “kalim” zëvendësohet me fjalën “qasje”.

Neni 19

Në nenin 116 pas paragrafit (1) pas pikës 21 shtohet pika e re 22, dhe bëhet:

“22. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës
- të dhënat nga Regjistri Qendror i Popullsisë.”

Neni 20

Në nenin 117 në paragrafin (1) pas fjalëve: “Ministria e Mbrojtjes - Zbulimi ushtarak,” shtohen fjalët: “Agjencia e Sigurisë Nacionale,”.

Në paragrafin (2) pika 2 fshihet.

Pika 3 bëhet pikë 2.

Pas paragrafit (6) shtohet paragraf i ri (7) dhe bëhet:

“(7) Për qëllimet e këtij ligji, drejtoria mund të këmbëjë të dhëna me të cilat disponon në bazat e tyre të të dhënave me organet sipas paragrafit (1) të këtij neni me kërkesë të tyre të arsyetuar me shkrim ose me iniciativë të tyre.”

Neni 21

Në nenin 124 në paragrafin (1) në nënparagrafin 2 në fund të fjalisë pas fjalës “ligji” shtohen fjalët: “si dhe numri i plotësimeve të pranuar të raporteve për transaksione të dyshimta”.

Në nënparagrafin 5 pas fjalës “organe” shtohen fjalët: “si dhe numri i plotësimeve të dorëzuara të raporteve të raporteve dhe njoftimeve”.

Neni 22

Në titullin para nenit 131, pas fjalës “masat”, shtohen fjalët: “edhe urdhëresa për ndjekje të marrëdhënies afariste”.

Në paragrafin (1) pas fjalës “nenet” shtohen fjalët: “119,”.

Në paragrafin (3), para fjalës "shteti", shtohen fjalët: "për ndjekje të marrëdhënies afariste dhe".

Neni 23

Në nenin 146 në paragrafin (1) në nënparagrafin 3 pas fjalëve: "shtëpi brokere", shtohen fjalët: "banka me leje për punë me letra me vlerë,".

Neni 24

Në nenin 148 në paragrafin (3) dhe 1 fshihet.

Neni 25

Në nenin 149 në paragrafin (1) pika 10) ndryshohet dhe bëhet:

Pikat 11) dhe 12) bëhen pika 10) dhe 11).

Në paragrafin (2), pika 6) fshihet.

Pikat 7), 8), 9) dhe 10) bëhen pika 6), 7), 8) dhe 9).

Neni 26

Në nenin 150 në paragrafin (1) në pikën 1) pas fjalës "kontrollon" shtohen fjalët: "edhe mbledh.

Neni 27

Në nenin 151 në paragrafin (1) pika 1) fshihet.

Pikat 2) dhe 3) bëhen pika 1) dhe 2).

Neni 28

Në nenin 154 në paragrafin (1) nëparagrafi 3 fshihet.

Në nënparagrafin 7 fjala "gjobë" zëvendësohet me fjalët: "sanksion për kundërvajtje".

Neni 29

Titulli para nenit 155 dhe neni 155 fshihet.

Neni 30

Në nenin 159 paragrafin (1) ndryshohet dhe bëhet:

"Për qëllimet e parandalimit dhe zbrapsjes nga kryerja e aktiviteteve të cilat konsiderohen si kundërvajtje në pajtim me këtë ligj, drejtoria është e obliguar në bazë të të dhënave të fituara në pajtim me nenin 154 të këtij ligji, t'i bëjë publike informacionet për gjobat e shqiptuara në bazë të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor, përveç nëse publikimi i informacionit mund të ndalojë zbatimin e procedurës parahetimore ose penale."

Paragrafi (4) fshihet.

Neni 31

Neni 160 ndryshon dhe bëhet:

"(1) Gjobë në shumë prej 60.000 deri në 80.000 euro kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk zbaton procedurë të analizës të klienti në pajtim me nenin 12 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të përforcuar gjatë vendosjes të sjelljes korrespondentë në pajtim me nenin 34 të këtij ligji;
- nuk refuzon lidhje të marrëdhënie afariste ose bën transaksion ose nuk e ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 39 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

- vendos ose vazhdon marrëdhënie afariste me shell bank (banka guaca) dhe të fillojë ose vazhdojë marrëdhënie afariste korrespondente me bankën me të cilën e di se lejon hapje dhe punë me konto te banka guaca në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (1) të këtij ligji;

- nëse ushtron aktivitet financiar të shell bank (bankë guacë) në kundërshtim me nenin 49 paragrafi (2) të këtij ligji;

- hap ose ruan konto anonime ose konto me emra fiktivë në kundërshtim me nenin 50 të këtij ligji;

- nuk dorëzon te drejtoria të dhëna, informata dhe dokumente në pajtim me nenin 54 paragrafi (1) të këtij ligji;

- banka nuk vë në përdorim ose nuk e mbingarkon softuerin për përpunim automatik të të dhënave në pajtim me nenin 59 të këtij ligji;

- thirret në sekret afarist në kundërshtim me nenin 69 të këtij ligji;

- nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, dorëzon të dhëna të paplota ose të pasakta ose nuk i dorëzon në afat në pajtim me nenin 115 të këtij ligji;

- nuk vepron në pajtim me urdhëresën për përcjellje të marrëdhënies afariste sipas nenit 119 të këtij ligji;

- nuk e mba transaksionin në bazë të urdhrin të lëshuar në pajtim me nenin 120 të këtij ligji.

(2) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik (tregtar i mesëm) do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 50.000 deri në 60.000 euro në kundërvlerë denari.

(3) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik (tregtar i vogël) do t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 30.000 deri në 50.000 euro në kundërvlerë denari.

(4) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit juridik (mikro tregtar) do t'i shqiptohet në shumë prej 20.000 deri në 40.000 euro në kundërvlerë denari.

(5) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, personave juridik sipas paragrafit (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalesë e përkohshme për ushtrimin e veprimtarie të caktuar në pajtim me ligj. Drejtoria mund të dorëzojë propozim të arsyetuar për marrje të përkohshme ose të përhershme të licencës, përkatësisht leje për punë personit juridik te organet kompetente për dhënien e tyre në pajtim me ligj.

(6) Gjobë në shumë prej 6.000 deri në 12.000 euro në kundërvlerë denari për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës të personit juridik sipas paragrafit (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

Personit përgjegjës të personit juridik sipas paragrafit (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

(7) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni krahas gjobës mund t'u shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligj.

(8) Për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni të bëra me qëllim, në mënyrë të organizuar, të cilat përsëriten, me të cilat është shkaktuar dëm i konsiderueshëm ose pajiset me dobi të konsiderueshme pronësore, personit juridik i shqiptohet gjobë në shumë prej 10% nga e hyra e personit juridik të realizuar vitin paraprak fiskal dhe sanksion kundërvajtës ndalesë e përkohshme për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në pajtim me ligj.”.

Neni 32

Neni 161 ndryshon dhe bëhet:

“(1) Gjohë në shumë prej 20.000 deri në 30.000 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk bën vlerësim të rrezikut në pajtim me nenin 10 të këtij ligji;
- nuk përpilon dhe nuk zbaton program në pajtim me nenin 11 paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk e miraton programin, nuk e monitoron dhe vlerëson rregullisht adekuatësinë e vet, harmonizimin dhe efikasitetin në pajtim me nenin 11 paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk i zbaton masat për analizë të klientit në pajtim me nenin 14 të këtij ligji;
- nuk e identifikon dhe nuk e konfirmon identitetin e klientit, autorizuesit ose pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 15 të këtij ligji;
- nuk e identifikon dhe nuk e konfirmon identitetin e klientit dhe autorizuesit në pajtim me nenin 16 të këtij ligji;
- nuk e identifikon dhe nuk e konfirmon identitetin e autorizuesit në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;
- nuk e identifikon dhe nuk e konfirmon identitetin e pronarit të vërtetë në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;
- nuk e respekton raportin afarist në pajtim me nenin 31 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të fuqizuar për klientin në pajtim me nenin 33 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të fuqizuar për klientin i cili nuk është i pranishëm në pajtim me nenin 35 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të fuqizuar për klientin – bartës i funksionit publik në pajtim me nenin 36 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të fuqizuar për klientët nga vendet me rrezik të lartë në pajtim me nenin 37 të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të fuqizuar për transaksione të ndërlikuara dhe të pazakonshme në pajtim me nenin 38 të këtij ligji;
- nuk i ruan të dhënat, informatat ose dokumentet në pajtim me nenin 51 të këtij ligji;
- nuk e njofton drejtorinë dhe nuk e mban transaksionin në pajtim me nenin 54 paragrafi (2) të këtij ligji;
- në drejtori, nuk dërgojnë të dhëna, informata dhe dokumente në formë të raportit në pajtim me nenin 54 paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk siguron zbatim të masave dhe veprimeve për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit në pajtim me nenin 41 të këtij ligji;
- obligimet për analizë të klientit, ua beson personave të tretë në kundërshtim me nenin 42 të këtij ligji;
- nuk siguron dhe nuk përcjellë informata në transferet e mjeteve monetare pa para të gatshme në pajtim me nenin 43 të këtij ligji;

- nuk verifikon identitet të klientit në pajtim me nenin 44 paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk verifikon identitet të klientit në pajtim me nenin 46 të këtij ligji;
- nuk verifikon identitet të klientit në pajtim me nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji;
- pranon para të gatshme në kundërshtim me nenin 48 të këtij ligji;
- bën regjistrim të letrave me vlerë, pronës tjetër ose punëve juridike, ose për paraqitje dhe transferim të parave, të letrave me vlerë ose pronës tjetër, mund të bën regjistrim të tillë ose transfer në kundërshtim me nenin 48 paragrafi

(2) të këtij ligji;

- nuk dërgon të dhëna në Drejtori në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;
- nuk i dërgon raportet në Drejtori në pajtim me nenin 56 të këtij ligji;
- nuk emëron person të autorizuar dhe zëvendës të vet në pajtim me nenin 57 paragrafi (1) të këtij ligji;
- nuk formon seksion të veçantë për parandalim të larjes së parave dhe financim të terrorizmit në pajtim me nenin 57 paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk siguron plotësim të kushteve në pajtim me nenin 57 paragrafi (8) të këtij ligji;
- përdor të dhëna të siguruara me këtë ligj në kundërshtim me nenin 60 të këtij ligji;
- e njoftojnë klientin ose person të tretë në pajtim me nenin 61 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i mesëm) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 10.000 deri 20.000 euro në kundërvlerë denari.

(3) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i vogël) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 5.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari.

(4) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar mikro) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 3.000 deri 8.000 euro në kundërvlerë denari.

(5) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personave juridik nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni mund t'u shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalesë e përkohshme për kryerje të ndonjë veprimtarie në pajtim me ligjin.

(6) Gjobë në shumë nga 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, krahas gjobës mund t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës, në pajtim me ligj." (7) Personit përgjegjës te personi juridik sipas paragrafit (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni përpos gjobës mund ti shqiptohet sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligj.

Neni 33

Neni 162 ndryshon dhe bëhet:

"(1) Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik (tregtar i madh), nëse:

- nuk e njofton drejtorinë në pajtim me nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji;

- nuk e parashtron programin me kërkesë të organeve kompetente për mbikëqyrje nga neni 146 i këtij ligji në pajtim me nenin 11 paragrafi (3) të këtij ligji;
- nuk zbaton analizë të thjeshtësuar të klientit në pajtim me nenin 32 të këtij ligji;
- nuk i vëren të dhënat sipas radhës kronologjike në regjistër me numeracion në punët ndryshuese në pajtim me nenin 45 të këtij ligji;
- nuk mban regjistër me numeracion për tregit me letra me vlerë shuma totale e të cilave është mbi 15.000 euro në kundërvlerë denari në pajtim me nenin 47 paragrafi (2) të këtij ligji;
- nuk e njoftojnë organin kompetent për mbikëqyrje nga neni 146 i këtij ligji që kanë parashtruar raport në drejtori në pajtim me nenin 54 paragrafi (6) të këtij ligji;
- punëson në seksion, persona që nuk i plotësojnë kushtet nga neni 57 paragrafët (6), (7) dhe (11) të këtij ligji;
- nuk siguron trajnim të rregullt profesional në pajtim me nenin 57 paragrafi (12) të këtij ligji;
- nuk dërgon të dhëna në Drejtori në pajtim me nenin 57 paragrafi (13) të këtij ligji.

(2) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i mesëm) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 3.000 deri 5.000 euro në kundërvlerë denari.

(3) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar i vogël) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 1.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë denari.

(4) Për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni, personit juridik (tregtar mikro) do t'i shqiptohet gjobë në shumë nga 800 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari.

(5) Gjobë në shumë nga 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari për veprimet sipas paragrafit (1) i këtij neni do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik sipas paragrafit (1), (2), (3) dhe (4)."

Neni 34

Neni 163 fshihet.

Neni 35

Në nenin 164 në paragrafin (1) pas nënparagrafit 1 shtohet nënparagrafi 2, dhe bëhet:

"- nuk refuzon vendosjen e marrëdhënies afariste ose kryen transaksion ose nuk e ndërpret marrëdhënien afariste me klientin në pajtim me nenin 39 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji,".

Paragrafi (2) ndryshon dhe bëhet:

"Personit i cili kryen autorizime publike ose personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni përpos gjobë mund t'i shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin."

Neni 36

Në nenin 165 në paragrafin (1) nënparagrafi 17 fshihet. Paragrafi (2) ndryshon dhe bëhet:

"Personit i cili kryen autorizime publike ose personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni përpos gjobë mund ti shqiptohet edhe sanksion për kundërvajtje ndalim për ushtrimin

e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në pajtim me ligjin.”

Neni 37

Në nenin 166 paragrafi (2) fshihet.

Neni 38

Në nenin 167 në paragrafin (1) në fjalinë hyrëse fjalët: “prej 10.000” zëvendësohet me fjalët: “nga 5.000 deri në 10.000”.

Neni 39

Në nenin 168 shuma “2.500” zëvendësohet me shumën “500” ndërsa shuma “5.000” zëvendësohet me shumën “1.000”.

Neni 40

Në nenin 169 në fjalinë hyrëse shuma “1.000” zëvendësohet me shumën “500” ndërsa shuma “2.000” zëvendësohet me shumën “1.000”.

Neni 41

Në nenin 171 paragrafi (2) ndryshon dhe bëhet:

“Nëse organet e mbikëqyrjes nga neni 146 të këtij ligji konstatojnë kundërvajtje nga nenet 164, 165, 166 dhe 167 të këtij ligji, hartojnë procesverbal, ku i shënojnë elementet themelore të veprimit prej ku rrjedh natyra juridike e kundërvajtjes, emri personal, adresa dhe numri unik i amzës së qytetarit, nëse bëhet fjalë për të huaj dhe numrin e dokumentit të udhëtimit dhe shtetit, ndërsa për personin juridik, emrin, selinë dhe numrin tatimor, kohën, vendin dhe mënyrën e kryerjes së kundërvajtjes, përshkrimin e veprimit, kualifikimin juridik të kundërvajtjes dhe personat e gjetur aty për aty, si dhe jep propozim për barazim me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje. Procesverbalin e nënshkruan organi i mbikëqyrjes, personi zyrtar i autorizuar dhe kryerësi.”

Paragrafi (3) ndryshon dhe bëhet:

“Në procedurën për barazim, gjoha në urdhërpagesën për kundërvajtje shqiptohet në shumë fikse të përcaktuar me ligj, ndërsa nëse gjoha është e përcaktuar në dallim shqiptohet shuma minimale e përcaktuar për kundërvajtjen.”.

Pas paragrafit (5) shtohen dy paragrafë të rinj (6) dhe (7) dhe bëhen:

“(6) Në procedurën e cila do të përfundojë me urdhërpagesë për kundërvajtje nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

(7) Kryerësi i cili me largimin për shkak të qëndrimit jashtë vendit mund ta evitojë pagesën e gjobës, është i obliguar menjëherë ta paguajë gjobën e shqiptuar me urdhërpagesën për kundërvajtje.”

Paragrafët (6), (7), (8), (9) dhe (10) bëhen paragrafë

(8), (9), (10), (11) dhe (12).

Neni 42

Në nenin 172 fjala "gjashtë" zëvendësohet me fjalën "katër".

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

Neni 43

Dispozita e nenit 1 me të cilën ndryshohet neni 14 paragrafi (1) pikat a) dhe b), dispozita e nenit 3 me të cilën ndryshohet neni 16 paragrafët (1) dhe (2), dispozita e nenit 12 me të cilën ndryshohet neni 51 paragrafi (1) të këtij ligji, do fillojnë të zbatohen nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit të Dokumenteve Elektronike, Identifikimit Elektronik dhe Shërbime të Besueshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 101/19 dhe 275/19).

Neni 44

Procedurat e filluara për kundërvajtje deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë në pajtim me dispozitat e Ligjit të Parandalimit të Larjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 120/2008).

Neni 45

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga botimi në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".